



THIRRJE PËR PROPOZIME

PROGRAMI "FUQIZIMI I GRAVE, MBROJTJA E TË DREJTAVE: RRUGA DREJT BARAZISË GJINORE NË SHQIPËRI"

AWEN - Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri, në kuadër të programit "Fuqizimi i Grave, Mbrojtja e të Drejtave: Rruga drejt Barazisë Gjinore në Shqipëri", financuar nga **Qeveria Suedeze**, shpall **Thirrjen e 6-të për Propozime mbi "Çështje për advokim lidhur me mbrojtjen, promovimin dhe respektimin e të drejtave me fokus tek të drejtat e grave në Shqipëri"**.

Me qëllim forcimin e mëtejshëm të përpjekjeve advokuese e lobuese të AWEN dhe organizatave të saj anëtare, duke mobilizuar më shumë aktorë dhe bashkëpunëtorë, duke shfrytëzuar njohuritë, qasjet dhe përvojat tematike (sidomos në ndërhyrje monitoruese *watch-dog*), AWEN **do të japë fonde për nisma advokuese dhe ndërgjegjësuese** që adresojnë çështje që kanë nevojë për vëmendje dhe ndërhyrje të menjëhershme.

Për këtë thirrje do të jenë prioritet ndërhyrjet advokuese, ndërgjegjësuese dhe monitoruese që adresojnë çështje të mosdiskriminimit për shkak të seksit, racës, etnisë, fesë apo besimit, aftësive të kufizuara, orientimit seksual, etj., si më poshtë:

- *Dhuna dhe krimi kibernetik, veçanërisht ndaj vajzave dhe grave;*
- *Diskriminimi direkt apo indirekt i grave dhe vajzave në edukim, punësim, familje, komunitetin ku jetojnë;*
- *Metoda dhe praktika inovative për të promovuar tolerancën dhe barazinë;*
- *Diskriminimi ndaj personave LGBTIQ+*

Shënim: *Lista e mësipërme nuk është shteruese dhe lë hapësirë për ndërhyrje relevante dhe emergjente lidhur me të drejtat e grave dhe vajzave/çështje të diskriminimit të cilat vlerësohen si urgjente, inovative dhe/apo me impakt të lartë dhe lidhen me zhvillimet aktuale në vend. Këtu përfshihen dhe ndërhyrje/iniciativa që lidhen me integrimin gjinor në çështjet mjedisore dhe klimatike.*

Ndërhyrje të tjera advokuese dhe monitoruese mund të jenë:

Ndërkohë që synohet të ndikohen axhendat qendrore dhe vendore për çështjet mosdiskriminimit, inkurajohet përfshirja e vendimmarrësve, partnerë në ndërhyrje, profesionistë, të rinj, etj. si partnerë të rëndësishëm ndryshimi dhe si pjesë e zgjidhjes.



Entitete që mund të aplikojnë:

- OJF-të që punojnë për çështje që adresojnë të drejtat e njeriut në Shqipëri;
- Grupime formale / të regjistruara të grave që punojnë në komunitete;
- Grupime joformale që punojnë në komunitete dhe që aplikojnë në bashkëpunim me një OJF lokale të regjistruar.

Madhësia e grantit: Grantet do të jenë në një minimum 2.000 EUR dhe maksimum prej 5.000 EUR.

Koha e zbatimit të projekteve: Kohëzgjatja e projektit mund të jetë për një maksimum prej 5 muajsh me mundësinë për të filluar nga 1 mars 2024.

Afati i fundit për aplikime: 18 shkurt, 2024

Vlerësimi i projekteve:

Aplikantët do të vlerësohen lidhur me potencialin e projektit për të pasur një ndikim të prekshëm për të përmirësuar respektimin e të drejtave të njeriut. Çdo projekt do të vlerësohet në bazë të kriterëve të mëposhtme të përzgjedhjes:

1. Qasja Teknike: Rëndësia e nevojave dhe çështjeve të adresuara; Arsyetimi i nevojës së menjëhershme për ndërhyrje; Cilësia e aktiviteteve të propozuara; Logjika e ndërhyrjes së orientuar drejt rezultateve.
2. Kapacitetet organizative/e grupimit: Kapacitetet organizative dhe administrative; Përvoja relevante në tema të ngjashme.
3. Buxheti i Propozuar: Kosto dhe shpenzime të përshtatshme për ndërhyrjen.

Dokumentet që duhet të dorëzohen:

- 1) Një projekt propozim i shkurtër sipas formatit bashkëlidhur;
- 2) Propozim buxheti për t'ua përdorur në mënyre efektive në linjë me qëllimet e projektit (aneks 1);
- 3) Dokumentacioni ligjor: Dokument regjistrimi në gjykatë të organizatës; Nipt; Ekstrakt bankar;
- 4) Në rastin e përfshirjes së një grupi joformal të grave, dokumentet shoqëruese duhet të përmbajnë prova të kompetencës dhe përvojës së mëparshme në ndërhyrje të ngjashme.



Informacion:

Nëse aplikantët kanë pyetje në lidhje me aplikimin ose kanë nevojë për më shumë informacion mbi thirrjen për propozime, mund të kërkojnë informacion ose të kërkojnë një takim informues gjatë fazës së aplikimit. Na kontaktoni në: info@awenetwork.org

Adresa ku duhet të dërgoni aplikimin:

Paketa e aplikimit që përfshin, projektin sipas formularit të bashkëngjitur të aplikimit, buxhetin dhe të gjitha dokumentet mbështetëse të skanuara, duhet të dërgohet në info@awenetwork.org dhe teuta.dedej@awenetwork.org

Ju lutem dërgoni aplikimin tuaj në anglisht – Nëse e keni të pamundur të përgatisni propozimin tuaj në anglisht, ju lutem dërgoni një kërkesë në adresën e emailit të AWEN (si më sipër).

Njoftimi lidhur me aprovimin do të bëhet brenda 10 ditëve nga data e përfundimit të afatit të aplikimeve. Vetëm aplikantët fitues do të njoftohen zyrtarisht me e-mail.